



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
Sekretaria

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_.05.2022

**MBLEDHJA Nr. 22,**  
**Datë 24.05.2022, ora 10:00**  
**e Bordit të ERE-s**

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Martë, datë 24.05.2022, ora 10:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 22 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së bordit të ERE-s më datë 19.05.2022
2. Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Hec Bishnica 1, 2” sh.p.k., parashtruar me shkresën e datës 21 Janar 2022, protokolluar me nr. 6/4 prot., datë 21.01.2022
3. Mbi licencimin e shoqërisë “SPV Blue 1” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik “Blue 1” me vendndodhje në zonën e Sheq Marinas, Bashkia Fier, me kapacitet të instaluar 50 MW
4. Mbi njohjen e licencës për furnizimin me energji elektrike nr. ZRRE/LI\_55/16, lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji të Republikës së Kosovës, me vendimin v\_968\_2018, datë 13.04.2018, për subjektin “Future Energy Trading And Exchange Dynamics sh.p.k.”, që ka regjistruar në shqipëri subjektin “Future Energy Trading and Exchange Dynamics sh.p.k.; dega në Tiranë”
5. Mbi njohjen e licencës për tregtimin e energjisë elektrike nr. ZRRE/LI\_72/21, lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji të Republikës së Kosovës, me vendimin v\_1400\_2021, datë 02.09.2021, për subjektin “Future Energy Trading and Exchange Dynamics sh.p.k. (FUENTE Dynamics)”, që ka regjistruar në shqipëri subjektin “Future Energy Trading and Exchange Dynamics sh.p.k.; dega në Tiranë”
6. Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “Kurum International” sh.a., me nr. 372, seria F12/17 në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 106, datë 20.07.2012, i ndryshuar
7. Mbi kërkesën e shoqërisë “Irarba Energji” sh.p.k. për transferimin e asetëve në favor të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë sh.a.

8. Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Egnatia Hydropower” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Gostima 1” me kapacitet të instaluar 3047 kW, “Gostima 2” me kapacitet të instaluar 5586 kW, “Gostima 3” me kapacitet të instaluar 5335 kW, “Gostima 4” me kapacitet të instaluar 7396 kW, “Gostima 5” me kapacitet të instaluar 10321 kW, “Gostima 5/1” me kapacitet të instaluar 450 kW dhe “Gostima 6” me kapacitet të instaluar 16819 kW, me kapacitet total të instaluar 48 864 kW
9. Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Egnatia Hydropower” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike
10. Çështje të tjera

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën [erealb@ere.gov.al](mailto:erealb@ere.gov.al), jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**